



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

datë. 15.07.2013
Nr.0204-858

PËR: Agron Kuçi, Kryetar i Komunës së Junikut,
Sinan Gacaferi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut,

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS SË JUNIKUT Nr.001/09, të pranuar më datën 28.06.2013.

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit, Nr.001/09, të miratuar me datë 30.05.2013, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i listuar si në vijim, ka efekt të plotë juridik.

- Vendim Nr.001/09, për çmimin më të lartë „Kuvendi i Junikut” post mortum i ndahet Richard Holbrook, diplomatit dhe ambasadorit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MAPL-së,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm i MAPL-së
Drejtoreve të Departamenteve dhe Drejtoreve të Zyrave
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Dana. 15.07.2013

Br. 0204-858

Za: Agron Kuçi, Gradonačelnik Opštine Junik
Sinan Gacaferi, Predsedavajući Skupštine Opštine Junik

PREDMET: POTVRDA ZAKONITOSTI ODLUKE OPŠTINE JUNIK Nr.001-09 primljene dana 28.06.2013.

Poštovani-e

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandatom određenim po Zakonu za lokalnu samoupravu br. 03/L-040, dodatak XII Uredbe Vlade 02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva, posle razmatranja Odluke, Nr.001-09, usvojene dana 30.05.2013, **POTVRJUJE** zakonitost ovog akta i procenjuje da je isti u skladu sa Zakonom za lokalnu samoupravu.

Pravni Akt niže navaden ima puni pravni efekat.

- Odluka 0Nr.001-09, za najveću nagradu-Skupština Junika-post mortum Richard Holbrook,diplomatu i ambasadoru Sjedinjenih Američkih Država.

S poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamanikpremijera i Ministar MALS-a,

Kopija: Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a
Rukovodiocima Uprava MALS-a
Arhivi MALS-a.



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA Komuna Junik-Opština Junik		
02/Nr. Post.	Nr. i faq.	Data
2-004-4162	1	28.05.2013



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY JUNIK

Kuvendi i Komunës

Nr. 001/09

Datë: 30.05.2013

Në bazë të nenit 40, paragrafi 40.2 pika h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/040, si dhe nenit 7, paragrafi 7.2, të Statusit të Komunës së Junikut të datës 29.9.2010, propozimit të Kryetarit të Komunës z. Agron Kuçi, Kuvendi Komunal Junik me datë: 30.05.2013, bie këtë:

VENDIM

Me rastin e përvjetorit të Kuvendit të Junikut, çmimi me i lartë „KUVENDI I JUNIKUT” post mortum i ndahet **Richard Holbrooke**, diplomatit dhe ambasadorit të Shteteve të bashkuara të Amerikës, i dërguari special i presidentit Clinton në bisedimet Kosovë – Serbi.

Arsyetim

Richard Holbrooke si diplomat i SHBA-së, gjatë luftës në Kosovë 1998/99, është caktuar nga presidenti i atëhershëm **Bill Clinton** si emisar special në zgjidhjen e çështjes Kosovë - Serbi. Gjatë periudhës së luftës ka kontribuar përmes ndërmjetësimit dhe presionit tek pala serbe për ta ndalë luftën dhe për të zgjidh problemin Kosovë – Serbi.

Richard Holbrooke jo vetëm në Kosovë por edhe me gjerë njihet si një diplomat i fuqishëm këmbëngulës dhe i aftë për situata të vështira në zgjidhjen e problemeve të rënda.

Vizita e Holbrooke në Junik në qershor të vitit 1998 shënon njohjen dhe legjitimimin e luftës së drejt, çlirimtare të U.Ç.K-së.

Andaj ndarja e çmimit „KUVENDI I JUNIKUT” është një nderë dhe respekt për kontributin e madh që ka dhënë në përfundimin e luftës dhe në kurorëzimin e krejt kësaj me lirinë dhe pavarësinë Kosovës.

Të njoftohen:

- Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë,
- Presidenca e Kosovës,
- Kuvendi i Kosovës,
- Qeveria e Kosovës,
- Arkivi.



Kryetari i Kuvendit
Sinan Gacaferi